



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Kosovës, nr. 01/07, lidhur me situatën e krijuar nga rreziku i përhapjes së korona virusit në Republikën e Kosovës dhe me qëllim të ndërmarrjes së masave preventive në Komunën e Vushtrrisë, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E SHTABIT PËR PARANDALIMIN E COVID-19 NË KOMUNËN
E VUSHTRRIË

1. Formohet Shtabi Komunal për koordinim të aktiviteteve preventive për parandalim të COVID 19 Në Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:
 - 1.1 Z. Sylejman Mehulli, Drejtor për shëndetësi dhe përkujdesje sociale - kryesues i shtabit
 - 1.2 Afrim Namani, Drejtor për Arsim, - anëtar
 - 1.3 Rrahim Ajeti, Drejtor për inspektime – anëtar
 - 1.4 Bajrush Kosumi, Drejtor për mbrojtje dhe shpëtim, - anëtar
 - 1.5 Refik Maloku, Drejtor për Shërbime Publike, anëtar
 - 1.6 Luljeta Zahiti, Drejtore e QKMF-së, anëtare
 - 1.7 Mursel Pllana, u.d. Drejtor i Spitalit, Vushtrri – anëtar
 - 1.8 Reshat Kovaçi, komandant i stacionit policor në Vushtrri, anëtar
 - 1.9 Haki Novolani, përfaqësues i bizneseve të komunës – anëtar
 - 1.10 Shemi Rrahimi, Kryetari BI në Vushtrri – anëtar
 - 1.11 Drita Dibrani, Kryetare e KVRL-së – anëtare
2. Detyrë e shtabit është që secili në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiive ligjore të ndërmerr masat e nevojshme për parandalim të shfaqjes përkatësisht përhapjes e Koronavirusit në komunën e Vushtrrisë. Duke ditur se epidemiologjia e koronavirusit tani më është shfaqur në të gjitha vendet fqinje, për shkak të rrezikut të përhapjes së saj edhe te ne, është më se e domosdoshme që të përcillen në çdo kohë kërkesat dhe rekomandimet e Qeverisë së Kosovës dhe Institucioneve më të larta shëndetësore me qëllim që të jemi në nivel të detyrës.
3. Shtabi komunal duhet të jetë i angazhuar 24 orë dhe vepror në bazë të rrethanave dhe situatës së krijuar në terren.

4. Për çdo veprim të ndërmarrë duhet njoftuar organet kompetente sipas ligjit në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës

